



RAPORT I NDËRMJETËM

GUSHT 2021

**MBI MONITORIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR (Maj – Korrik 2021)**

PARATHËNIE

Në raportin e tretë të ndërmjetëm, është marrë në shqyrtim veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) dhe strukturës ndihmëse hetimore gjatë periudhës maj – korrik 2021.

Gjatë kësaj periudhe konstatohet se Prokuroria e Posaçme ka nisur disa hetime të reja ndaj disa subjekteve të posaçëm (të zgjedhur apo të emëruar) dhe ka përfunduar disa hetime që kanë qenë të regjistruara nga Prokuroria E Krimeve të Rënda. Kanë avancuar procedurat për emërimin e stafit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe stafit ndihmës administrativ. Ndërkohë, po vazhdon procedura e rekrutimit të grupit të dytë të agjentëve të BKH.

Në datën 25 prill 2021 u mbajtën zgjedhjet parlamentare për Kuvendin e Shqipërisë dhe për shkak të disa ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, Prokuroria e Posaçme është përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen e disa krimeve zgjedhore. Periudha në monitorim ka patur një aktivitet të zgjedhur të Prokurorisë së Posaçme në lidhje me hetimin e veprave penale që përfshijnë zgjedhjet. Kjo nisur edhe nga numri i lartë i referimeve që kanë bërë individë, apo subjekteve zgjedhore.

NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE DHE NDIHMËSE HETIMORE

Gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar procesi i rekrutimeve të stafit ndihmës administrativ dhe të stafit ndihmës hetimor. Edhe në këtë fazë, ashtu si në gjetjet e raportit të dytë të ndërmjetëm, vihet re një përparim i ngadalshëm. Në Prill 2021 është hapur thirrja e dytë për rekrutimin e 32 hetuesve të tjerë të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) duke qenë se në procedurën e parë vetëm 28 kandidatë mundën të kualifikohen nga 60 që ishte numri i kërkuar. Aktualisht janë përmbyllur fazat e testimit fizik dhe në muajin korrik është zhvilluar faza e intervistimit të aplikantëve. Ashtu si dhe procedura e parë, edhe kjo procedurë po merr kohë për verifikimin e plotë të kandidatëve.

Pavarësisht përparimit të ngadalshëm, tashmë BKH ka filluar të funksionojë. Në muajin maj 2021, pasi janë përmbyllur të gjitha konkurset, procedurat hetimore dhe administrative, është bërë emërimi i 28 hetuesve të parë të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH). Pasi kanë përfunduar edhe trajnimin e thelluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ata tashmë janë atashuar pranë Prokurorisë së Posaçme për ofrimin e asistencës gjatë veprimtarisë hetimore.

Gjithashtu në muajin korrik është bërë plotësimi i plotë i strukturës së prokurorisë së posaçme me 15 prokurorë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), ka emëruar së fundmi prokurorët A.Xh dhe D.B si pjesë të Prokurorisë së Posaçme. Emërimi i tyre plotëson strukturën me prokurorë. Megjithatë, konstatohet se prej krijimit të kësaj strukturë janë dashur më shumë se 2 vjet për plotësimin e saj. Nga ndjekja e këtij procesi, si një nga faktorët kryesorë në vonimin e plotësimit të strukturës së Prokurorisë së Posaçme, veç hezitimit të trupës së prokurorëve për të aplikuar, është edhe procesi i rivlerësimit. Gjatë kësaj periudhë trupat e rivlerësimit kanë vendosur të shkarkojnë nga detyra disa prej kandidatëve që ishin në garë për tu bërë pjesë e Prokurorisë së Posaçme si A.N dhe B.H. Ndërkohë që prokurorja E.I, pasi kaloi me sukses fazën e parë të procesit të rivlerësimit, vendosi të heqë dorë nga procesi për emërimin në Prokurorinë e Posaçme.

Ndërsa është plotësuar struktura e prokurorisë, po vazhdon puna për ngritjen e strukturës ndihmëse administrative. Gjatë kësaj periudhe, Prokuroria e Posaçme ka njoftuar vazhdimisht hapjen e procedurave për rekrutimin e nëpunësve administrativë. Në raportin e fundit të veprimtarisë së saj Prokuroria e Posaçme njofton se nuk ka mundur të ezaurojë të gjithë buxhetin e saj, për shkak mungesave në strukturës.

TË DHËNAT MBI VEPRIMTARINË HETIMORE

Gjatë kësaj periudhe, Prokuroria e Posaçme ka mundur të mbyllë disa hetime të nisura nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe janë çuar për gjykim disa çështje me objekt trafikim të lëndëve narkotike të kryera nga grupe ndërkombëtare. Këto hetime janë kryer në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit në disa shtete si SHBA, Itali, Kroaci etj.

Sipas të dhënave të administruara nga Prokuroria e Posaçme gjatë kësaj periudhe është regjistruar një hetim i ri për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike. Ndërkohë janë çuar për gjykim gjithsej shtatë çështje që kanë të bëjnë me vepra penale të korrupsionit, krijimit të organizatave kriminale, trafikimit të narkotikëve etj. Nga 8 (tetë) çështjet e referuara, në 4 (katër) prej tyre kemi persona në hetim apo gjykim, subjekte të posaçëm si të zgjedhur, apo nëpunës publikë apo zyrtarë të tjerë të nivelit më të ulët (Tabela 1).

Në muajin korrik, Prokuroria e Posaçme ka njoftuar se ka nisur hetimet ndaj kryetarit të bashkisë Lushnjë për dyshime se ka konsumuar veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”. Në kuadër të

të njëjtit hetim, janë ngritur akuza edhe për 8 zyrtarë të tjerë të emëruar. Po ashtu Prokuroria e Posaçme ka dërguar për gjykim çështjen ndaj ish kryetarit të bashkisë Pogradec për veprën penale të shkeljes së barazisë në tender. Së bashku me të janë dërguar për gjykim edhe 5 zyrtarë të tjerë.

Prokuroria e Posaçme është duke zhvilluar disa hetime edhe ndaj ish gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë larguar nga detyra pasojë e procesit të rivlerësimit, për veprat penale të mos deklarimit dhe refuzimit për deklarimin e pasurisë. Në kuadër të këtyre hetimeve, Prokuroria ka kërkuar sekuestrimin e pasurisë të ish gjyqtarëve të lartë F.L, B.D dhe Sh.S.

Njoftimet SPAK për Veprimtarinë Hetimore

Nr.	Datë Njoftimi	Nr. Procedimi	Subjekti	Posaçëm	Vepra Penale	Regjistrim Procedimi	Statusi - Nën Hetim	Dërgim për Gjykim	Data
1	14/05/2021	102/2	E.P	Po	287,259 KP	07.10.2020	X		
2	17.06.2021	98/1	Ardian Çapja, Florenc Çapja, Olsi Leka	Jo	79/dh, 278/2, 28/4, 333/a e 334	17.06.2021		X	17.06.2021
3	6/7/21	199	Fatos Tushe, Flamur Peqini, Ibrahim Lami, Bujar Murati, Gazmend Çela	Po	259, 258, 248, 186 dhe 25	22.07.2020		X	05.07.2021
4	07.07.2021	181/2020	Talo Çela, Nudredin Dumani	Jo	79/d/dh, 278/1, 28/4, 333/a/1, 334	24.11.2020		X	06.07.2021
5	12.07.2021	69	Eduart Kapri, Avdulla Cano, Nexhmi Torra	Po	258, 248	12.07.2021		X	12.07.2021
6	15.07.2021	177/2	Leonard Duka, Oltjan Loga, Dritan Agaj	Jo	28/4, 333/a/2 dhe 334/1, 287/2/3	2019		X	15.07.2021
7	16.07.2021	89/1	Florin Ahmetaj	Po	258,248	28.01.2019		X	16.07.2021
8	16.07.2021	174/1	24 te Pandehur Bukurije, Elvis Ahmetaj	Jo	278/2 KP	16.07.2021		X	

HETIMET NË LIDHJE ME KRIMET ZGJEDHORE

Sipas ndryshimeve të fundit të bëra në Kodin e Procedurës Penale, një pjesë e krimeve zgjedhore të parashikuara në Kodin Penal do të hetohen nga Prokuroria e Posaçme. Në datën 25 prill 2021 u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare për Kuvendin e Shqipërisë. Periudha post zgjedhore u karakterizua nga kontestime të rezultatit të zgjedhjeve dhe dyshimeve për kryerjen e veprave penale zgjedhore.

Në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm dhe në Prokurorinë e Posaçme janë referuar një numër i madh kallëzimesh për konsumin e veprave penale që lidhen me zgjedhjet. Sipas njoftimit të bërë nga Prokuroria e Posaçme, dy ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve janë regjistruar

gjithsej 33 procedime penale. Natyra e veprave penale është e ndryshme dhe ka të bëjë me korrupsionin gjatë procesit zgjedhor, përdorimin e funksionit, shpërdorim detyre etj. Nga 33 procedime penale të regjistruara, shpërndarja e procedimeve sipas veprave është:

- 27 procedime penale për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 Kodi Penal.
- 2 procedime penale për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 328 dhe 328/b Kodi Penal.
- 2 procedime penale për veprën penale “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikuar nga neni 328/a Kodi Penal. (E lidhur me subjekte në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme)
- 1 procedim penal për veprat penale “Shpërdorim detyre” dhe “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 248 dhe 328 Kodi Penal.
- 1 procedim penal për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Përhapja e sekreteve vetjake”, parashikuar nga nenet 328 dhe 122 Kodi Penal.

Ndërkohë sipas njoftimit të fundit që ka bërë Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me krimet zgjedhore në datën 10 qershor 2021, nga të gjitha njoftimet apo referimet që janë bërë në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm (gjithsej 41 të tilla), për 23 prej tyre është vendosur kalimi për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme. Ky numër i shtohet numrit prej 33 referimesh të bëra drejtpërdrejtë në Prokurorinë e Posaçme.

Nuk ka njoftime për dërgim të çështjeve në gjykim apo përfundim të ndonjë procesi për veprat penale kundër zgjedhjeve.

PËRFUNDIME PARAPRAKE

Nga monitorimi i veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme dhe BKH, si në aspektin e veprimtarisë administrative dhe gjatë veprimtarisë hetimore dhe proceduese, konstatohet se:

- Megjithëse BKH ka nisur nga puna zyrtarisht duke u emëruar 28 hetuesit e parë, po përparohet ngadalë në drejtim të rekrutimit të të gjithë stafit të parashikuar me gjithsej 60 hetues.
- Prokuroria e Posaçme ka rekrutuar të gjithë stafin e prokurorëve, gjithsej 15, por ka ende vështirësi në rekrutimin e stafit ndihmës administrativ. Duke qenë se struktura drejtuese është tashmë e kompletuar, nuk shikohen arsye të vonesave në drejtim të përmbylljes së procedurave për rekrutimin e stafit administrativ;

- Në lidhje me veprimtarinë hetimore, konstatohet intensifikim i disa hetimeve, në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, ku janë të përfshirë subjekte të posaçme, të zgjedhur dhe disa zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të ulët administrativ;
 - Është përmbyllur së paku një operacion i përbashkët hetimi dhe gjurmimi mes disa shtetesh për trafikimin e lëndëve narkotike dhe krijimin e organizatave kriminale;
 - Janë përmbyllur tre hetime në lidhje me veprën penale të refuzimit të deklarimit të pasurisë ndaj ish gjyqtarëve të shkarkuar nga procesi i rivlerësimit. Për këto janë mbyllur edhe hetimet pasurorë në kuadër të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dhe është pranuar nga Gjykata e Posaçme kërkesa e Prokurorisë për sekuestrimin e disa prej aseteve të tyre;
 - Prokuroria e Posaçme për shkak të ndryshimeve procedurale, këtë periudhe ka qenë e ngarkuar edhe me hetimin e veprave penale në lidhje me krimet zgjedhore. Janë regjistruar për herë të parë në Prokurorinë e Posaçme 33 kallëzime dhe 23 janë përcjellë për kompetencë nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm. Pavarësisht kësaj, ende nuk ka një rezultat të plotë.
-
-